VENDIM
Nr. 684, datë 14.11.2018

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË TRUALL, PËR NDËRTIMIN E NJË KAPANONI INDUSTRIAL NJË KAT-REPART PËRPUNIMI, NGA ANA E SHOQËRISË "*LASER TUBE ALBANIA*" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, të sipërfaqes prej 6 213 (gjashtë mijë e dyqind e trembëdhjetë) m², sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e një kapanoni industrial një kat-repart përpunimi, nga ana e shoqërisë "*Laser Tube Albania*" sh.p.k.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Durrës të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore në tokë truall, për sipërfaqen prej 6 213 (gjashtë mijë e dyqind e trembëdhjetë) m², sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Durrës, Këshilli i Qarkut Durrës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Lidhja 1

Tokë arë (kategoria VI)

Bashkia	**Njësia Administrative**	**Fshati**	**Zona kadastrale**	**Numri i pasurisë**	**Pronari**	**Lloji i pasurisë**	**Kategoria e tokës bujqësore**	**Truall i kërkuar (m²)**
Durrës	Rrashbull	Stacioni i Zooteknisës, Xhafzotaj	2574	162/114	Shoqëria "Laser Tube Albania" sh.p.k.	Arë	VI	6 213
TOTALI								**6 213**